

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Liria e Tubimit

Liria e tubimit paqësor është e garantuar. Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të tjerëve.

Constitutional Paragraph: Neni 43

Liria e tubimit paqësor është e garantuar. Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të tjerëve.

Instrumentet ndërkombëtare

Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor

Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

Nenet

Neni 5 d (vi)

(vi) E drejta e pjesëmarrjes së barabartë në veprimtari kulturore;

Neni 21

Njihet e drejta e mbledhjes paqësore. Ushtrimi i kësaj të drejte mund të jetë objekt vetëm i kufizimeve që diktohen sipas ligjit dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, të qetësisë dhe rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik, apo të drejtat dhe liritë e tjerëve.

NENI 11.1

Liria e tubimit dhe e organizimit

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj
Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj

Neni 11.2

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t' u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut

Neni 20.

1. Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor.
2. Asnjëri nuk duhet të detyrohet të bëjë pjesë në ndonjë bashkim.

Ligjet

Nenet

Ligji për Lirinë e
Asocimit në
Organizata
Joqeveritare Nr.
06/L- 043

Neni 9

Liria e tubimit

Ligji për Lirinë e
Asocimit në
Organizata
Joqeveritare Nr.
06/L- 043

OJQ, përfshirë anëtarët apo zyrtarët e saj, gëzon të drejtën e tubimit paqësor sipas legjisllacionit në fuqi në Republikën e Kosovës

Ligji Nr. 02/L-31
PËR LIRINË
FETARE NË
KOSOVË

Neni 1.1.2a

1.2. E drejta për lirinë fetare dhe të besimit përfshinë, mes tjerash, edhe liritë në vijim:

Ligji Nr. 02/L-31
PËR LIRINË
FETARE NË
KOSOVË

a. Lirinë e adhurimit ose tubimit në lidhje me një fe ose besim, dhe krijimin dhe mirëmbajtjen e vendeve për këto qëllime;

Ligji Nr. 02/L-31
PËR LIRINË
FETARE NË
KOSOVË

Neni 1.1.3

1.3 Liria për të manifestuar fenë ose besimin duhet t'iu nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve që janë të parashkruara me ligj dhe janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit dhe moralit, dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të të tjerëve.

Ligji Nr. 02/L-31
PËR LIRINË
FETARE NË
KOSOVË

Ligjet**Nenet**

Neni 1

Qëllimi

LIGJI NR. 08/L-166
PËR TUBIME
PUBLIKE

1. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë ushtrimin e së drejtës kushtetuese për tubime publike, si dhe të drejtës për të organizuar dhe marrë pjesë në ngjarje publike.

LIGJI NR. 08/L-166
PËR TUBIME
PUBLIKE

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim rregullimin e kohës dhe mënyrës së lajmërimit të tubimeve publike dhe ngjarjeve publike, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e organizatorëve dhe Policisë së Kosovës për zbatim të këtij ligji.

LIGJI NR. 08/L-166
PËR TUBIME
PUBLIKE

Neni 2

Fusha e veprimit

LIGJI NR. 08/L-166
PËR TUBIME
PUBLIKE

Dispozitat e këtij ligji janë të obligueshme për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, organizatorët, si dhe për pjesëmarrësit në tubime publike dhe ngjarje publike.

Neni 4

E drejta për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime publike

LIGJI NR. 08/L-166
PËR TUBIME
PUBLIKE

1. Secili person pa dallim gjinie, race, ngjyre, gjuhe, besimi, përkatësisë nacionale, gjendje ekonomike e financiare, arsimore e sociale, të bindjeve politike apo bindjeve të tjera ose të çdo lloj rrethane tjetër personale, ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në tubime publike, sipas rregullave të përcaktuara me këtë ligj.

LIGJI NR. 08/L-166
PËR TUBIME
PUBLIKE

2. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm me ligj dhe kur është e domosdoshme dhe proporcionale për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare apo mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Këto kufizime në asnjë mënyrë nuk mund të mohojnë thelbin e të drejtave të garantuara për lirinë e tubimeve publike dhe të drejtën për të organizuar ngjarjet publike e për të marrë pjesë në to.

Për me shumë informata konsultojeni ligjin përkatës:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=70935>

decisionTitle***decisionDescription***

UNITED
MACEDONIAN
ORGANISATION
ILINDEN AND IVANOV
v. BULGARIA
(Application no.
44079/98) 20 October
2005

Aplikantët u ankuan sipas nenit 11 të Konventës se ata ishin ndaluar të mbajnë tubime paqësore gjatë periudhës 1998-2003. Sipas mendimit të tyre, ndërhyrjet me të drejtën e tyre për tubim paqësor nuk ishin justifikuar sipas paragrafit 2 të nenit 11. **Gjykata njëzëri konstaton se ka shkelje të nenit 11 të Konventës;**

decisionTitle***decisionDescription***

B?CZKOWSKI AND
OTHERS v. POLAND
(Application no. 1543/06)
3 May 2007

Aplikantët pohonin shkelje të Neneve 11, 13 dhe 14 të KEDNJ në lidhje me nenin 11, pasi u ishte refuzuar leja për të demonstruar që të ngritnin ndërgjegjësimin për diskriminimin kundër homoseksualëve.

Aplikantët (Fondacioni për Barazi dhe një grup individësh aktivë në OJQ që përfaqësojnë të drejtat homoseksualëve) planifikuan të mbajnë një marshim dhe një numër të shesheve për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për diskriminimin kundër pakicave. Autoritetet administrative, duke vepruar në emër të Kryetarit të Bashkisë së Varshavës, refuzuan t'i jepnin aplikantëve leje për marshim. Gjykata njëzëri hodhi poshtë vërejtjet paraprake të Qeverisë dhe **konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 11 dhe neneve 13 dhe 14** të ndërmarra në lidhje me nenin 11.

TER-PETROSYAN v.
ARMENIA (Application
no. 36469/08) 25 April
2019

Aplikanti u ankua se e drejta e tij për lirinë e tubimit paqësor ishte shkelur si pasojë e ndërhyrjes së paligjshme dhe joproportionale të policisë, gjegjësisht shpërndarjes së tubimit në "Sheshin e Lirisë" dhe se ai nuk kishte pasur asnjë mjet efektiv kundër shkeljes së kësaj të drejte .

Gjykata rithekson që një ndërhyrje do të përbëjë një shkelje të nenit 11 përveç nëse "parashikohet me ligj", ndjek një ose më shumë qëllime legjitime sipas paragrafit 2 dhe është "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për arritjen e këtyre qëllimeve.

Gjykata njëzëri konstaton se ka pasur shkelje të nenit 11 të Konventës;

Sigurdur a. Sigurjónsson
v. Iceland

Në këtë çështje, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se arsyet e parashtruara nga Qeveria, edhe pse munden të konsiderohen të rëndësishme, nuk janë të mjaftueshme për të treguar se ishte "e domosdoshme" për të detyruar aplikantin për të qenë anëtar i shoqates Frami, në rrezikun e humbjes së licencës së tij dhe në kundërshtim me mendimet e tij. Në veçanti, pavarësisht kufirit të vlerësimit të Islandës, masat e këtilla kufizuese nuk ishin në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur. Rrjedhimisht, Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 11.

decisionTitle***decisionDescription***

Maestri v. Italy
(39748/98) [2004] ECHR
76 (17 February 2004)

(39748/98) [2004] ECHR 76 (17 February 2004)

Faktet: Aplikuesi ishte shtetas italian dhe kryetar i Gjykatës së Qarkut La Spezia. Procedimet disiplinore u ngritën kundër tij pasi kishte qenë një anëtar i një shoqate masonike. Parashtruesi pretendonte se vendosja e sanksionit ndaj tij shkelti nenet 9 (e drejta për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë), 10 (liria e shprehjes) dhe 11 (liria e tubimit dhe asocimit) të Konventës. **Gjykata konstatoi shkelje të nenit 11 me arsyetimin se kishte pasur ndërhyrje në të drejtën e aplikantit për lirinë e asocimit, siç garantohet me nenin 11.** Ndërhyrja nuk ishte përcaktuar me ligj sepse rregullorja kombëtare mbi të cilën ishte bazuar masa disiplinore nuk kishte bazë në të drejtën vendase dhe nuk arriti të plotësonte kushtet e qasjes dhe parashikueshmërisë. Në të vërtetë, formulimi i direktivës që përshkruante sanksionin nuk ishte mjaftueshëm i qartë dhe i parashikueshëm për t'i mundësuar kërkuesit të kuptonte se anëtarësia e tij në një shoqatë masonike mund të çonte në sanksione ndaj tij.